



Bruksel, më 24.7.2020

COM(2020) 608 versioni përfundimtar

SHTOJCAT 1 deri në 4

SHTOJCAT

e

KOMUNIKATËS SË KOMISIONIT DREJTUAR PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLIT, KOMITETIT EVROPIAN EKONOMIK DHE SOCIAL DHE KOMITETIT TË RAJONEVE

Plani i Veprimit i BE-së 2020-2025 për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit

SHTOJCA 1

Listë e legjislacionit përkatës dhe iniciativave të BE-së

Legjislacioni i BE-së

- Direktiva e Këshillit 91/477/KEE "Për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjen e armëve" *Gazeta Zyrtare L 256, 13.9.1991, f. 51* (e ndryshuar);
- Qëndrimi i Përbashkët (CFSP) 2008/944, datë 8 dhjetor 2008 që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksportit të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2019/1560, datë 16 shtator 2019, *Gazeta Zyrtare L 239, 17.9.2019, f. 16*;
- Direktiva 2009/43/KE, datë 6 maj 2009, që thjeshtëson kushtet e transferimit të produkteve për mbrojtjen brenda Komunitetit, *Gazeta Zyrtare L 146, 10.6.2009, f. 1*;
- Rregullorja (BE) Nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 mars 2012, "Për zbatimin e nenit 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve të tyre dhe municioneve, që plotëson konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar (Protokolli i OKB-së për armët e zjarrit) dhe që përcakton autorizimin e eksportit, si dhe masat për importin dhe transitin e armëve të zjarrit, të pjesëve dhe komponentëve të tyre dhe të municioneve" *Gazeta Zyrtare L 94, 30.3.2012, f. 1*;
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2015/2403 "Për përcaktimin e udhëzimeve të përbashkëta për standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar kthimin në jofunksionale në mënyrë të pakthyeshme të armëve të zjarrit të çaktivizuara" *Gazeta Zyrtare L 333, 19.12.2015, f. 62* (e ndryshuar);
- Direktiva Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/68, datë 16 janar 2019 "Për përcaktimin e specifikimeve teknike për markimin e armëve të zjarrit dhe komponentëve të tyre kryesorë" sipas Direktivës së Këshillit 91/477/KEE "Për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjen e armëve" *Gazeta Zyrtare L 15, 17.1.2019, f. 18*;
- Direktiva Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/69, datë 16 janar 2019 "Për përcaktimin e specifikimeve teknike për armët alarmuese dhe sinjalizuese" sipas Direktivës së Këshillit 91/477/KEE "Për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjen e armëve" *Gazeta Zyrtare L 15, 17.1.2019, f. 22*;
- Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2019/686, datë 16 janar 2019 "Për përcaktimin e marrëveshjeve të detajuara" sipas Direktivës së Këshillit 91/477/KEE "Për shkëmbimin sistematik, në formë elektronike, të informacionit që lidhet me transferimin e armëve të zjarrit brenda Unionit", *Gazeta Zyrtare L 116, 3.5.2019, f. 1*;
- Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2019/689, datë 16 janar 2019, "Për një projekt pilot për zbatimin e disa dispozitave të bashkëpunimit administrativ, të përcaktuara në Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, përmes Sistemit të Brendshëm të Informacionit të Tregut; *Gazeta Zyrtare L 116, 3.5.2019, f. 75*.

Instrumentet ndërkombëtare

- Konventa e vitit 2001 kundër krimit të organizuar transkombëtar dhe Protokollin e saj për prodhimin dhe trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve të tyre, si dhe të municioneve;

- Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara i vitit 2001, "Për parandalimin, luftën dhe eliminimin e tregtisë së jashtëligjshme të armëve të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet;
- Instrumenti Ndërkombëtar i vitit 2005 që i mundëson shteteve të identifikojnë dhe gjurmojnë, në kohë dhe në mënyrë të besueshme, armët e vogla dhe armët e lehta të jashtëligjshme;
- Traktati për Tregtinë e Armëve i vitit 2013.

Iniciativat e BE-së

Të përgjithshme

- Cikli i Politikave të BE-së 2014-2018, plani i parë operacional i veprimit në kuadër të Platformës Evropiane Shumëdisiplinore kundër Kërcënimeve Kriminale.¹ Këtu përfshihen një sërë aktivitetesh të orientuara drejt rritjes së nivelit të mbledhjes, grumbullimit dhe gjenerimit të inteligjencës, përmirësimit të informacionit balistik, ngritjes së njërive qendrore kombëtare, organizimit të operacioneve të përbashkëta të kontrollit për kërcënime specifike (armët e konvertuara, armët me gaz dhe ato për alarm, dërgimi i pakove), trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, si dhe drejt bashkëpunimit ndërkombëtar.
- *Armët e zjarrit dhe siguria e brendshme e BE-së: mbrojtja e qytetarëve dhe ndërprerja e trafikimit të paligjshëm*, Komunikatë e Komisionit drejtuar Këshillit dhe Parlamentit Evropian, COM (2013) 716, datë 21.10.2013.
- *Axhenda Evropiane për Sigurinë*, Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social, si dhe Komitetit të *Rajoneve*, COM (2015) 185, versioni përfundimtar i datës 28.4.2015.
- Plani i veprimit të BE-së kundër trafikimit dhe përdorimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit dhe lëndëve plasëse, COM(2015) 624, versioni përfundimtar i datës 2.12.2015.
- *Elementet drejt një Strategjie të BE-së kundër armëve të jashtëligjshme të zjarrit, armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre*, Komunikatë e Përbashkët e Komisionit dhe e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (JOIN(2018) 17 versioni përfundimtar, 1.6.2018), e miratuar nga Këshilli, dhe e kthyer kështu në një Strategji gjithëpërfshirëse të BE-së (Konkluzionet e Këshillit të datës 19 nëntor 2018 – Dokumenti 13581/18).
- Raporti i Komisionit për një vlerësim lidhur me zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 258/2012 "Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit për përdorim civil, COM(2017) 737 versioni përfundimtar, 12.12.2017.
- Rekomandimi i Komisionit "Për hapat e menjëhershëm për të përmirësuar sigurinë e eksportit, importit dhe masave të transitit për armët e zjarrit, pjesët dhe komponentët kryesore të tyre dhe municionet", ku kërkohet fuqizimi i rregullave të BE-së me qëllim rritjen e gjurmueshmërisë dhe sigurisë së procedurave të kontrollit të eksportit dhe importit të armëve të zjarrit, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, C(2018) 2197 versioni përfundimtar, 17.4.2018.

Evropa Juglindore

¹ Dok. 16726/3/13 RISH 3 RESTREINT UE/I KUFIZUAR NGA BE.

- *Plani i Veprimit për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit ndërmjet BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore, për periudhën 2015-2019, 14 nëntor 2014, Dokumenti i Këshillit 15516/14, miratuar nga Këshilli, datë 4 dhe 5 dhjetor 2014 (Dokumenti i Këshillit 16526/14); Forumi Ministror mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme i datës 12 dhjetor 2014, i mbajtur në Beograd.*
- *Një perspektivë e besueshme zgjerimi dhe rritje e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor, COM(2018) 65 versioni përfundimtar, 6.2.2018. Masa 2.12 fokusohet specifikisht në trafikimin e armëve të zjarrit.*
- *Plani i Përbashkët i Veprimit për luftën kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, i nënshkruar nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor më 5 tetor 2018 në Forumin Ministror mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, të mbajtur në Tiranë.² Trajtimi i çështjes së trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit është pjesë e pesë objektivave të tij gjithëpërfshirës. Janë hartuar në mënyrë të përbashkët marrëveshje dypalëshe të posaçme për luftën kundër terrorizmit, të cilat janë konkluduar me autoritetet e të gjashtë partnerëve të Ballkanit Perëndimor.³ Këtu përfshihen çështjet kryesore të trafikimit të armëve të zjarrit, si ngritja e njërive qendrore plotësisht funksionale për armët e zjarrit. Masat prioritare janë përgatitur sipas të dhënave konkrete të përgjegjësive, treguesve dhe afateve kohore.*
- *Udhërrëfyesi për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e AVL-ve dhe municioneve të tyre, Samiti i Londrës në kuadër të Procesit të Berlinit më 10 korrik 2018. Më pas, kjo iniciativë mori mbështetje financiare nga BE përmes një Vendimi të Këshillit (CFSP) 2018/1788 të 19 nëntorit 2018 në mbështetje të Zyrës Qendrore në Evropën Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) për zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal për luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve në Ballkanin Perëndimor, ku përcaktohet koordinimi dhe monitorimi i përgjithshëm i zbatimit të Udhërrëfyesit, Gazeta Zyrtare L 293, 20.11.2018, f. 11.*
- *Vlerësimi i Planit të Veprimit 2015-2019 për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve të zjarrit ndërmjet BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore, Raport i Komisionit i 27 korrikut 2019, COM(2019) 293 versioni përfundimtar, 27.06.2019. Sipas këtij raporti vlerësimi, plani i veprimit solli përmirësime në krijimin e kontakteve, shkëmbimin e informacionit dhe hedhjen e themeleve për bashkëpunim në të ardhmen. Megjithatë, disa masa të planifikuara nuk janë zbatuar ende plotësisht, si p.sh. ngritja e njërive qendrore për armët e zjarrit, të cilat janë të nevojshme për të realizuar në mënyrë të përshtatshme strategjitë e zbatimit, koordinimin, shkëmbimet e inteligjencës dhe informacionit, në nivel kombëtar dhe evropian. Gjithashtu, ende nuk është*

² https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/news/docs/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf.

³ Dy marrëveshjet e para janë nënshkruar nga Komisioneri Avramopoulos dhe Ministri i Brendshëm të Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 9 tetor 2019 në Bruksel, shihni https://ec.europa.eu/home-affairs/news/news/20191009_security-union-implementing-counter-terrorism-arrangements-albania-north-macedonia. Marrëveshja me Kosovën* u nënshkrua në Bruksel më 30 tetor 2019. Tre marrëveshjet e fundit, me Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë, u nënshkruan më 19 nëntor 2019 gjatë punimeve të Takimit Ministror për ÇBD në Shkup.

* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

harmonizuar mbledhja e të dhënave për armët e zjarrit të sekuestruara, çka do të mundësonte një politikë të bazuar në fakte, si dhe vlerësim të përshtatshëm dhe të besueshëm të tendencave të trafikimit. Në mënyrë të ngjashme, grupet e interesit nuk kanë hartuar një format standard raportimi për shkëmbimin e informacionit, siç parashikohet në Planin e Veprimit.


- Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2111, datë 9 dhjetor 2019, në mbështetje të veprimtarive të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore që redukton kërcënimin që vjen nga armët e vogla dhe armët e lehta të jashtëligjshme, si dhe nga municionet e tyre, *Gazeta Zyrtare L 318, 10.12.2019: Që nga viti 2002, BE ka ofruar mbështetje për Ballkanin Perëndimor përmes disa Vendimeve të Këshillit, të cilat kanë ofruar financime për projektet e kontrollit të armëve të vogla, me vlerë 18,1 milionë euro.*
- Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2009, datë 2 dhjetor 2019, në mbështetje të përpjekjeve të Ukrainës për të luftuar trafikimin e jashtëligjshëm të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, në bashkëpunim me OSBE; *Gazeta Zyrtare L 312, 3.12.2019, f. 42.*

Këto projekte kanë ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse për projektet e kontrollit të AVL-ve dhe për parandalimin e trafikimit të armëve në Evropën Juglindore. Që nga viti 2002, partneri kryesor zbatues i asistencës së ofruar nga Këshilli në rajon ka qenë Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) e UNDP-së. Vendimi i ri i Këshillit, datë 9 dhjetor 2019, jep 11,8 milion euro për aktivitetet e kontrollit të armëve, në 4 vitet e ardhshme. Komisionet e Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Rrjeti i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit në Evropën Juglindore kontribuojnë në standardizimin e qasjeve në rajon dhe formulimin e aktiviteteve në nivele rajonale dhe vendore, duke kontribuar në politikëbërje të bazuar në prova; rritje të sigurisë fizike dhe menaxhimit të stoqeve; përmirësim të markimit, gjurmimit dhe mbajtjes së të dhënave; fuqizim të kapaciteteve në luftën kundër trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të zjarrit përmes mbështetjes për ngritjen e pikave qendrore për armët e zjarrit dhe fuqizimit të kapaciteteve hetimore. Gjithashtu, është ofruar mbështetje për rritjen e ndërgjegjësimit, për fushatat e mbledhjes së AVL-ve dhe municioneve, për të rritur transparencën e eksporteve të armëve në rajon dhe për të integruar perspektivën gjinore në kontrollin e AVL-ve.

- *Politika e partneritetit lindor pas vitit 2020*, Komunikata e Përbashkët, JOIN(2020) 7 versioni përfundimtar, 18.3.2020; ritheksuan thirrjen e bërë në Rishikimin e Politikës Evropiane të Fqinjësisë (ENP), të vitit 2015, për të zgjeruar dimensionin e sigurisë me qëllim parandalimin e krimit të organizuar, duke përfshirë trafikimin e armëve të zjarrit.

SHTOJCA 2

Logjika e ndërhyrjes e Planit të Veprimit të BE-së



SHTOJCA 3
Masat specifike për Evropën Juglindore dhe bashkëpunimi i saj me BE-në

Masat	Kiadri kohor ⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës ⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal ⁶
Kushtet mundësuese			
<i>Mjedisi ligjor</i>			
Kontroll ligjor plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-së (duke përfshirë rishikimin e vitit 2017 të Direktivës së Armëve të Zjarrit), duke përfshirë aktet zbatuese për standardet e çaktivizimit, për markimin e armëve të zjarrit dhe komponentëve kryesorë të tyre dhe specifikimet teknike për armët alarmuese dhe sinjalizuese.	2023	1.1; 1.2; 1.3	Q1, S3
Përditësimi i kuadrit ligjor për prodhuesit dhe tregtarët e armëve të zjarrit	2020	1.1; 1.4; 1.5	Q1, S2
Krijimi i kuadrit të përshtatshëm ligjor penal për të garantuar ndjekjen penale dhe dënimin e autorëve të trafikimit të armëve të zjarrit.	2024	1.5 3	Q1 S1 Q3 S1

⁴ Kuadri kohor i Udhërrëfyesit Rajonal.

⁵ Shihni shtojcën 4.

⁶ Q=Qëllimi; S=Synimi.

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
Përafrimi i procedurave penale dhe operacionale në mbarë rajonin për të lehtësuar bashkëpunimin operacional ndërkufitar.	2023	1.1 3	Q1 S4 Q3 S1
Miratimi i kuadrit ligjor për të lejuar legalizimin e armëve të zjarrit dhe dorëzimin vullnetar të armëve të zjarrit, municioneve dhe lëndëve plasëse.	2020	11	Q5, S2
<i>Struktura administrative</i>			
Ngritja e njësive qendrore për armët e zjarrit, plotësisht funksionale dhe të pajisura me stafin përkatës, në çdo juridiksion.	2020	7	Q2 S2 Q2 S3
<i>Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve</i>			
Përmirësimi i proceseve, pajisjeve dhe trajnimi i njësive ligjzbatuese.	2024	7	Q3, S2
Rritja e trajnimeve kombëtare për parandalimin e trafikimit të armëve të zjarrit. Diversifikimi i pjesëmarrësve në kurset e trajnimit të CEPOL.	2024	7	Q3, S4

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
Parandalimi dhe rritja e ndërgjegjësimit			
<i>Rritja e sigurisë së stoqeve</i>			
Krijimi i sistemeve të inspektimit dhe zbatimi i Menaxhimit të Ciklit të Jetës për armët e vogla dhe të lehta, për subjektet shtetërore dhe private. Ofrimi i trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve për të dy llojet e subjekteve.	2024	12.4	Q7 S1 Q7 S3 Q7 S4
Garantimi i mjediseve të sigurta të magazinimit për armët e zjarrit	2024	13	Q7, S2
<i>Reduktimi i stokut</i>			
Shkatërrim sistematik i tepricave dhe armëve të konfiskuara	2024	12.2, 12.3, 12.5, 12.6	Q6
<i>Dorëzimet vullnetare dhe programet e riblerjes</i>			
Krijimi i programeve kombëtare dhe rajonale për çaktivizimin, legalizimin dhe dorëzimet vullnetare, si dhe për shkatërrimin sipas standardeve.	2024	11	Q5, S3

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
<i>Fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit dhe dimensionit gjinor</i>			
Realizimi i fushatave të rritjes së ndërgjegjësimit në popullatën e përgjithshme dhe me grupe specifike (p.sh., prodhuesit, personat fizikë dhe juridikë të licencuar), ngritja e rrjeteve të advokimit.	2024	2 14	Q4
Integrimi i plotë i çështjeve për gjininë në politikat për kontrollin e armëve të zjarrit dhe garantimi i pjesëmarrjes reale të grave në kontrollin e armëve të zjarrit dhe zbatimin e ligjit.	2022	2.3	Q2, S9
Zbatim më i fortë i ligjit			
<i>Inteligjenca</i>			
Standardizimi i procedurave, sistematizimi i shkëmbimit të informacionit, duke përfshirë përtej hetimeve individuale.	2023	9	Q1, S5
Krijimi i sistemeve për mbledhjen gjithëpërfshirëse të të dhënave për refuzimet që lidhen me armët e zjarrit (pronësinë, transferimet, autorizimet e importit ose eksportit), për krimet me armë dhe konfiskimet e armëve. Mbledhje sistematike e të	2024	2.2 3 6 7 8	Q2 S1 Q2 S5 Q3 S1

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
dhënave për drejtësinë penale nga të gjithë aktorët (policia, doganat, prokuroritë, gjykatat, shërbimet e burgut). Publikimi i raporteve periodike për krimet me armë dhe i vlerësimeve të kërcënimeve.			
Mbledhje sistematike e të dhënave lidhur me armët e zjarrit dhe komponentët kryesorë të humbur ose të vjedhur me qëllim gjurmimin e tyre, duke përfshirë përdorimin e iARMS.	2022	5 7	Q2 S8
<i>Kontrolle ligjore të rrepta</i>			
Mbledhja e statistikave të detajuara mbi pronësinë dhe lëvizjet e armëve të zjarrit (autorizimet e importeve dhe eksporteve).	2024	2	Q2 S1 Q5 S4
Forcimi i kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të devijimit.	2024	1; 6.3; 6.4	Q1 S5 Q3 S3 Q5 S1, Q5 S4
Fuqizimi i bashkëpunimit operacional (patrulla të përbashkëta, përfshirje më e lartë e policisë dhe bashkëpunim me doganat, duke përfshirë qendrat e bashkëpunimit), rritje të përdorimit të asistencës ndërkombëtare dhe instrumenteve të posaçme hetimore të ofruara nga EMPACT dhe Europol.	2024	9	Q3, S4

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
<i>Gjurmimi</i>			
Realizimi i gjurmimeve sistematike për të gjitha armët e konfiskuara, dhe shkëmbimi i informacioneve me Europol.	2024	5	Q1 S5 Q2 S7
<i>Analiza balistike</i>			
Sistematizimi i analizës balistike dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit balistik	2020	7	Q2, S4
<i>Shkëmbimi i informacionit në të gjitha fazat</i>			
Të vazhdohet shkëmbimi i praktikave të mira në mënyrë periodike në një mjedis administrativ të integruar (ku të mos ketë mbivendosje ndërmjet takimeve, të jenë më të qarta pritshmëritë për rezultatet e takimit dhe përfaqësuesit e shteteve të kenë mandat dhe mundësi të qarta për të ndërmarrë angazhime), dhe të përfshihen shërbimet e doganave, policisë, kriminalistikës, prokurorive dhe gjykatës.	2023		Q1, S6
Të garantohet shkëmbimi sistematik i informacionit operacional dhe strategjik për armët e zjarrit në platformën EMPACT (përdorimi i lidhjeve të përshtatshme në SIENA), me Europol, Frontex dhe Eurojust. Të garantohet që marrësi tu përgjigjet	2024	8	Q2 S4 Q2 S6

Masat	Kuadri kohor⁴	Treguesit përkatës kyçë të performancës⁵	Aktivitetet përkatëse në Udhërrëfyesin Rajonal⁶
<p>rregullisht dhe në mënyrë sistematike kërkesave për informacion dhe dhënies së informacionit.</p> <p>Mbledhja e informacionit dhe krijimi i një tabloje me informacione të sakta mbi përdorimin e Darknet për tregtinë e jashtëligjshme të armëve të zjarrit, në kuadër të Ciklit të Politikave të BE-së.</p>	2021		

SHTOJCA 4

Treguesit kyçë të performancës

Treguesit në vijim janë zhvilluar në Udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024. Ata janë formuluar në këtë shtojcë në një mënyrë të tillë që të aplikohen edhe për vendet anëtare të BE-së. Kjo nuk ndikon në mënyrën se si partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë nisur të raportojnë mbi zbatimin e Udhërrëfyesit. Numrat e vendosur për treguesit nuk janë ndryshuar.

1. Numri i kuadrove ligjore për kontrollin e armëve plotësisht të harmonizuar me legjislacionin e BE-së,⁷ Traktati për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokollin për Armët e Zjarrit)
 - 1.1. Aktet ligjore për kontrollin e armëve lidhur me përdorimin civil të armëve të zjarrit dhe municioneve janë në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së për armët e zjarrit dhe municionet;
 - 1.2. Aktet ligjore për kontrollin e armëve lidhur me përdorimin civil të lëndëve plasëse janë të harmonizuara me Direktivat përkatëse të BE-së për lëndët plasëse;
 - 1.3. Aktet ligjore për kontrollin e armëve lidhur me përdorimin ushtarak të armëve të zjarrit, municioneve dhe lëndëve plasëse janë të harmonizuara me Direktivën 2009/43/KE;
 - 1.4. Aktet ligjore për kontrollin e armëve janë në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët CFSP 2008/944 dhe me Traktatin për Tregtinë e Armëve;
 - 1.5. Aktet ligjore për kontrollin e armëve janë në përputhje me Protokollin për Armët e Zjarrit.
2. Vetëm për Evropën Juglindore: Numri i dokumenteve të politikave për kontrollin e armëve të bazuara në fakte, të hartuar në secilin juridiksion, të cilat trajtojnë gjithashtu nevojat e burrave, të grave, djemve dhe vajzave;
 - 2.1. Ekziston Strategjia për AVL-të.
 - 2.2. Strategjia për AVL-të është e bazuar në fakte.
 - 2.3. Strategjia për AVL-të trajton nevojat e burrave, grave, djemve dhe vajzave.
3. Numri i rasteve, individëve të përfshirë dhe sasia e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) të keqpërdorura dhe të trafikuar të çuara për ndjekje penale dhe të gjuakura krahasuar me numrin e raporteve të institucioneve ligjzbatuese për konfiskimet përkatëse;
4. Numri i rasteve dhe sasia e AME të kapura në territorin e brendshëm (duke përfshirë në kufijtë ndërmjet vendeve anëtare brenda Bashkimit Evropian) krahasuar me

⁷ Shihni shënimin 1 në fund të faqes më lart.

numrin e rasteve dhe sasinë e AME të kapura në kufi (kufijtë e partnerëve të Evropës Juglindore ose kufijtë e jashtëm të BE-së);

- 4.1. Numri i rasteve të AME të kapura në territorin e brendshëm;
 - 4.2. Numri i armëve të zjarrit të kapura në territorin e brendshëm;
 - 4.3. Numri i copëve të municioneve të kapura në territorin e brendshëm;
 - 4.4. Sasia e lëndëve plasëse të kapura në territorin e brendshëm;
 - 4.5. Numri i rasteve të AME të kapura në kufi;
 - 4.6. Numri i rasteve të armëve të zjarrit të kapura në kufi;
 - 4.7. Numri i copëve të municioneve të kapura në kufi;
 - 4.8. Sasia e lëndëve plasëse të kapura në kufi.
5. Numri i rasteve të raportuara të AME të kapura në kufijtë e Bashkimit Evropian dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore, krahasuar me numrin e AME të kapura në të gjithë Bashkimin Evropian dhe me prejardhje ose të devijuara nga Evropa Juglindore;
- 5.1. [nuk zbatohet – është mbuluar në pikën 4.2]
 - 5.2. [nuk zbatohet – është mbuluar në pikën 4.3]
 - 5.3. [nuk zbatohet – është mbuluar në pikën 4.4]
 - 5.4. Numri i armëve të zjarrit të kapura në kufijtë e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore;
 - 5.5. Sasia e municioneve të kapura në kufijtë e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore;
 - 5.6. Sasia e lëndëve plasëse të kapura në kufijtë e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore;
 - 5.7. Numri i armëve të zjarrit të kapura në të gjithë territorin e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore;
 - 5.8. Sasia e municioneve të kapura në të gjithë territorin e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore;
 - 5.9. Sasia e lëndëve plasëse të kapura në të gjithë territorin e BE-së dhe me prejardhje nga Evropa Juglindore.
6. Numri i AME për të cilat janë lëshuar licenca eksporti nga autoritetet kompetente kombëtare, të identifikuar si të devijuara
- 6.1. Numri i licencave të eksportit të armëve, të lëshuara dhe realizuara;
 - 6.2. Numri i licencave të eksportit të municioneve, të lëshuara dhe realizuara;
 - 6.3. Numri i rasteve ku armët, për të cilat janë lëshuar dhe realizuar licencat, janë identifikuar si të devijuara
 - 6.4. Numri i rasteve ku municionet, për të cilat janë lëshuar dhe realizuar licencat, janë identifikuar si të devijuara nëpërmjet procedurës së kontrollit pas transportit.

7. Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit dhe ngritja e kapaciteteve
- 7.1. Njësi Qendrore për Armët e Zjarrit (FFP), të cilat janë të ngritura dhe funksionale në secilin juridiksion dhe të cilat plotësojnë standardet e Udhëzuesit të praktikave më të mira të BE-së;⁸
- 7.2. Numri i pjesëtarëve të stafit që kanë marrë trajnime lidhur me kërcënimet nga armët e zjarrit, në nivel BE-je (kryesisht trajnime të CEPOL) dhe në nivel kombëtar (me përjashtim të trajnimeve zinxhir (të llojit trajno trajnuesin)).

8. Numri i rasteve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel operacional, duke përfshirë hetimin, ndjekjen penale dhe fazat paraprake të procedurave gjyqësore;
 - 8.1. Numri i incidenteve me AME të regjistruara nga autoritetet ligjzbatuese;
 - 8.2. Rastet AME të gjykuara nga një gjykatës për veprat e kundërvajtjes;
 - 8.3. Rastet AME, të zgjidhura nga një gjykatës për veprat e kundërvajtjes;
 - 8.4. Numri i rasteve AME të rrëzuara nga prokuroria;
 - 8.5. Numri i rasteve AME të rrëzuara nga gjykatësi/gjykatësi hetues.

9. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional që rezultojnë nga informacioni i inteligjencës, duke përfshirë inteligjencën balistike në luftën kundër krimeve me armë zjarri, me vendet anëtare të BE-së, autoritetet dhe agjencitë e Evropës Juglindore, si dhe me agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit;
 - 9.1. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional, të drejtuara nga inteligjenca, në nivel juridiksioni;
 - 9.2. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional, të drejtuara nga inteligjenca, në Evropën Juglindore;
 - 9.3. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional, të drejtuara nga inteligjenca, me Frontex;
 - 9.4. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional, të drejtuara nga inteligjenca, me Europol/EMPACT;
 - 9.5. Numri i operacioneve dypalëshe të drejtuara nga inteligjenca ndërmjet partnerëve të Evropës Juglindore dhe vendeve anëtare të BE-së që nuk përfshijnë Europolin;
 - 9.6. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional, të drejtuara nga inteligjenca, me Interpol.
 - 9.7. Vetëm për BE-në: Numri i operacioneve dypalëshe të drejtuara nga inteligjenca ndërmjet vendeve anëtare të BE-së që nuk përfshijnë Europol/EMPACT;
 - 9.8. Vetëm për BE-në: Numri i regjistrimeve dhe kërkimeve në Sistemin e Informacionit të Schengen;
 - 9.9. Vetëm për BE-në: Numri i regjistrimeve dhe kërkimeve në Sistemin e Menaxhimit të Rreziqeve në Dogana;

⁸ 15 maj 2018, Dokumenti i Këshillit Nr. 8586/18.

10. Numri i incidenteve që përfshijnë armë zjarri dhe i viktimave të prekura nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, në çdo juridiksion;
 - 10.1. Numri i incidenteve të kryera me armë zjarri të ligjshme dhe të jashtëligjshme;
 - 10.2. Numri i personave të vrarë me armë zjarri, sipas gjinisë dhe moshës;
 - 10.3. Numri i personave të plagosur me armë zjarri, sipas gjinisë dhe moshës;
 - 10.4. Numri i personave, të cilët kanë kryer vetëvrasje me armë zjarri, sipas gjinisë dhe moshës.

11. Numri i AME-ve dhe municioneve të dorëzuara vullnetarisht, si edhe i armëve të zjarrit të legalizuara ose të çaktivizuara;
 - 11.1. Numri i armëve të zjarrit të dorëzuara vullnetarisht;
 - 11.2. Numri i municioneve të dorëzuara vullnetarisht;
 - 11.3. Numri i armëve të zjarrit të legalizuara;
 - 11.4. Numri i armëve të zjarrit të çaktivizuara sipas standardeve të BE-së.

12. Numri i AVL/armëve të zjarrit, municioneve dhe lëndëve plasëse (të konfiskuar ose tepricë) që shkatërrohet sistematikisht
 - 12.1. Sasia e armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse të raportuara si të konfiskuara;
 - 12.2. Sasia e armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse të konfiskuara dhe të shkatërruara;
 - 12.3. Sasia e armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse të konfiskuara dhe të asgjësuara në mënyra të tjera;
 - 12.4. Sasia e armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse;
 - 12.5. Sasia e tepricës së armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse të shkatërruara;
 - 12.6. Sasia e tepricës së armëve të zjarrit/municioneve/lëndëve plasëse të asgjësuara në mënyra të tjera.

13. Numri i depove për magazinimin e AVL-ve/armëve të zjarrit dhe të municioneve të tyre që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë;
 - 13.1. Numri i depove ushtarake për magazinimin e AVL-ve dhe të municioneve;
 - 13.2. Numri i depove të agjencive ligjzbatuese për magazinimin e AVL-ve/armëve të zjarrit dhe të municioneve;
 - 13.3. Numri i depove civile për magazinimin e armëve të zjarrit dhe të municioneve;
 - 13.4. Numri i depove ushtarake që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë;
 - 13.5. Numri i depove të agjencive ligjzbatuese që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë;
 - 13.6. Numri i depove civile për magazinimin e armëve të zjarrit dhe të municioneve që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë.

14. Përqindja e qytetarëve të kënaqur (të ndarë sipas moshës dhe gjinisë) ose që ndihen të sigurt nga dhuna me armë.
- 14.1. Përqindja e qytetarëve që ndihen të kërcënuar nga zotërimi i jashtëligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve.